



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 746/12 Prot.

Pogradec, më 27.02.2022

VENDIM

NR. 13, DATË 18.02.2022

**“PËR NJE NDRYSHIM NE VKB NR 120 DT 24.12.2021
“ MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR
VITIN 2022”**

Në mbështetje të, shkronjës "c", pika 1.3, të nenit 9, neneve 34, 40, 41, shkronjës "dh" të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor te Republikës te Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimin nr.120 datë 24.12.2021” “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2022” , VKB nr 109 dt 02.12.2021 “Per themelimin e Qendres Multifunkionale Pogradec SHA dhe miratimin e Akt themelit”, VKB nr 110 dt 02.12.2021 “Per miratimin e statutit te Qendres Multifunkionale Pogradec SHA”, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Te miratoje nje ndryshim ne Buxhetin e vitit 2022 duke filluar si me poshte:

1.1. Miratimi i pezullimit se Qendres Kulturore me kod institucioni 2136011 dhe krijim e Qendres Multifunkionale Pogradec SHA.



1.2. Plani i shpenzimeve te Qendres Multifunkionale Pogradec SHA do te jete i percaktuar ne Buxhetin e vitit 2022 ne shumen 57,563,000 leke.

1.3. Plani per Bashkine Pogradec (Qendres Multifunkionale Pogradec SHA.) tek llogaria 604 (Transferime korrente te brendshme) ne shumen 57,563,000 leke.

1.4. Bilanci i SHA do të jetë pjesë e bilancit të Institucionit përkatës.

1.5. Inventarët do të pasqyrohen tek Bilanci i SHA përkatëse.

1.6. Detyrimet e prapambetura te Qendres Kulturore me kod institucioni 2136011 do të kalojnë si Detyrime tek Bashkia Pogradec me kod institucioni 2136001.

1.7. Kontratat e regjistruara në SIFQ në Degën e Thesarit do të çregjistrohen për tu reregjistruar dhe pasqyruar tek SHA.

2. Te miratoje numrin e punonjesve per vitin 2022, **734 punonjes** si me poshte:

1. Bashkia Qëndër, Njësitë Administrative dhe MZSH	310 punonjës
2. Qendra Arsimore	242 punonjës
3. Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike	122 punonjës
4. Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit	60 punonjës

2.1 Numri i punonjësve me kontratë shërbimi të përkohshme në Bashkinë Pogradec për vitin **2021** është menduar të mbetet i pandryshuar, **65** (gjashtëdhjetë e pesë), mbi numrin e përgjithshëm (**734 punonjës**).Efektet financiare do te fillojne nga 01.01.2022.

3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar, Qendra Kulturero "Lasgush Poradeci", Qendra Multifunkionale Pogradec SHA.

4. Ky Vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

